ALBKROM SHA (NE LIKUIDIM E SIPER)

T I R A N E

PASQYRAT FINANCIARE VITI 2012

Bilanci -forma e gjate

Njësia ekonomike mund të zgjedhë që informacionet për nëzërat e bilancit, t'i paraqesë drejtpërsëdrejti në pasqyrën e Bilancit dhe jo në shënimet shpjeguese. Sipas SKK2 në këtë rast formati i Bilancit mund të paraqitet si vijon:

A	AKTIVI	Shënime	Viti raportues 31.12.2012	Viti paraardhës 31.12.2011
I	**AKTIVET AFATSHKURTRA**		**185,132,740**	**216,742,020**
1	**Aktive monetare**	1	13,704,626	25,328,558
2	Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim			-
	(i) Derivativët			-
	(ii) Aktivet e mbajtura për tregtim			-
	Totali 2		-	-
3	**Aktive të tjera financiare afatshkurtra**	2	155,096,219	166,528,609
	(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme		11,140,344	18,321,502
	(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme		137,555,875	137,099,805
	(iii) Instrumente të tjera borxhi		6,400,000	11,107,302
	(iv) Investime të tjera financiare			-
	Totali 3		-	-
4	**Inventari**	3	16,331,895	24,884,853
	(i) Lëndët e para		40,801,981	42,327,246
	(ii) Prodhim në proces			-
	(iii) Produkte të gatshme		55,067,714	71,401,420
	(iv) Mallra për rishitje		28,633,850	28,633,850
	(v) Parapagesat për furnizime		- 108,171,650	(117,477,663)
	Totali 4		**16,331,895**	**24,884,853**
5	**Aktivet biologjike afatshkurtra**			-
6	**Aktivet afatshkurtra të mbajtura për shitje**			-
7	**Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra**			-
	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA (I)		**16,331,895**	**24,884,853**
II	**AKTIVET AFATGJATA**	4	4,175,873,065	4,276,954,416
1	**Investimet financiare afatgjata**			
	(i) Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara (vetëm në PF)			-
	(ii) Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje			-
	(iii) Aksione dhe letra të tjera me vlerë			-
	(iv) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme afatgjata		4,819,585	4,910,329
	Totali 1.		**4,819,585**	**4,910,329**
2	**Aktive afatgjata materiale**		**186,995,016**	**287,985,623**
	(i) Toka		68,335,634	68,335,634
	(ii) Ndërtesa		32,344,112	43,033,586
	(iii) Makineri dhe pajisje		53,723,398	119,306,384
	(iv) Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)		32,591,872	57,310,019

REPUBLIKA E SHQIPERISE - SHOQERIA ANONIME "ALBKROM" - TIRANE

	Totali 2			
3	**Aktivet Biologjike afatgjata**			-
4	**Aktivet afatgjata jomateriale**			
	(i) Emri i mirë			-
	(ii) Shpenzimet e zhvillimit			-
	(iii) Aktive të tjera afatgjata jomateriale		3,984,058,464	3,984,058,464
	Totali 4		**3,984,058,464**	**3,984,058,464**
5	**Kapital aksionar i papaguar**			-
6	**Aktive të tjera afatgjata**			-
	TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA (II)			
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		**4,361,005,805**	**4,493,696,436**

B	PASIVI	Shënime	Viti raportues 31.12.2012	Viti paraardhës 31.12.2011
	DETYRIMET DHE KAPITALI			
I	**DETYRIMET AFATSHKURTRA**	5	**722,973**	**1,172,156**
1	**Derivativët**			-
2	**Huamarrjet**			
	(i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra			-
	(ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata			-
	(iii) Bono të konvertueshme			-
	Totali 2		-	-
3	**Huatë dhe parapagimet**		**722,973**	**1,172,156**
	(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve		459,136	922,987
	(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve			-
	(iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore		-	-
	(iv) Hua të tjera (mardhenie te brendeshme)		-	-
	(v) Parapagimet e arkëtuara		263,837	249,169
	Totali 3		**722,973**	**1,172,156**
4	**Grantet dhe të ardhurat e shtyra**			-
5	**Provizionet afatshkurtra**			-
	TOTALI I DETYR. AFATSHKURTRA (I)			
II	**DETYRIME AFATGJATA**	6	**2,681,601,652**	**2,810,235,594**
1	**Huatë afatgjata**			
	(i) Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare		63,144,352	63,144,352
	(ii) Bonot e konvertueshme			-
	Totali 1		-	-
2	**Huamarrje të tjera afatgjata**		169,840,292	298,474,234
3	**Grantet dhe të ardhurat e shtyra**		106,201,290	106,201,290
4	Te drejta e detyrime te Konçensionarit		2,342,415,718	2,342,415,718
				-

	TOTALI I DETYR. AFATGJATA (II)		-	-
	TOTALI I DETYRIMEVE			
III	KAPITALI	7	1,678,681,180	1,682,288,686
1	Aksionet e pakicës (përdoret vetëm në pasqyrat financiare të konsoliduara)			-
2	Kapitali që i përket aksionarëve të shoqërisë mëmë (përdoret vetëm në PF të konsoliduara)			-
3	Kapitali i rregjistruar(aksionar)		3,405,413,240	3,405,413,240
4	Primi i aksionit			-
5	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)			-
6	Rezerva statutore		1,545,062,358	1,545,062,358
7	Rezerva ligjore		39,410,111	39,410,111
8	Rezerva të tjera		25,074,303	25,074,303
9	Fitimet(humbja) e pashpërndara		- 3,332,671,326	(3,332,671,326)
10	Fitimi (humbja) e vitit financiar		- 3,607,506	-
	TOTALI I KAPITALIT (III)			
	Koncesioni		-	-
	TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT (I,II,III)		4,361,005,805	4,493,696,436

Kontrolli kuadrimit aktiv-pasiv		OK	OK
	Diferenca	(0)	

A- PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

(Bazuar në klasifikimin e Shpenzimeve sipas Natyrës)

#REF!

	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti raportues 31.12.2012	Viti paraardhës 31.12.2011
1	Shitjet neto	11	5,342,075	13,205,311
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit(Puna e kryer nga njesia	.	7,075,910	21,060,296
3	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proçes	.	-	-
4	Materialet dhe mallrat e konsumuara	11	(9,313,999)	(27,003,569)
5	Kosto e punës	11		-

	Pagat e personelit		(13,437,559)	(19,981,672)
	Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		(1,877,554)	(2,216,795)
6	Amortizimet dhe zhvlerësimet		(100,792,451)	(87,818,955)
7	Shpenzime të tjera		(8,135,154)	(2,569,805)
8	**Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)**		**(133,556,717)**	**(139,590,796)**
9	**Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)**		**(121,138,732)**	**(105,325,189)**
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara			(27,481,172)
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet			(66,212,274)
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	11		
	12.1 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financia		5,000,000	3,700,000
	12.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667		608,801	977,509
	12.3 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669		129,891	366,580
	12.4 Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668		111,792,534	(23,815,231)
13	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.		**117,531,226**	**(112,464,588)**
14	**Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)**	-67.53%	**(3,607,506)**	**(217,789,777)**
15	**Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 69**	12	-	-
16	**Fitmi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)**	11	**(3,607,506)**	**(217,789,777)**
17	**Elementët e pasqyrave të konsoliduara**		-	-

Kontrolli me shumen e fitimit neto ne bilanc		
Diferenca	(3,607,506)	(217,789,777)

#REF!

	Pasqyra e fluksit monetar – Metoda idirekte	**Shenime**	**Viti raportues 2012**	**Viti paraardhes 2011**
	Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
	Fitimi para tatimit		(3,607,506)	(217,789,776)
	Rregullime për:			
	Amortizimin		(100,792,451)	(87,818,955)
	Humbje nga këmbimet valutore			

Të ardhura nga investimet		0	0
Shpenzime për interesa		111,792,534	(23,815,231)
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktiviteti, si dhe kë			571,502,281
Rritje/rënie në tepricën inventarit			(98,128,874)
Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti			(295,606,124)
Rritje/rënie e shpenzimeve te shtyra			
Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet		**7,392,577**	**- 151,656,679**
Interesi i paguar			
Tatim mbi fitimin i paguar		-	0
Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		**7,392,577**	**- 151,656,679**
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara		0	0
Blerja e aktiveve afatgjata materiale			
Të ardhura nga shitja e pajisjeve			0
Interesi i arkëtuar		608,801	977,509
Dividendët e arkëtuar		0	0
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese		**608,801**	**977,509**
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksioner			
Hyrje nga huamarrje afatgjata			0
Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		0	0
Dividendët e paguar		0	0
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare			
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		**- 11,623,932**	**- 581,653**
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		**25,328,558**	**25,910,211**
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		**13,704,626**	**25,328,558**

Kontrolli	OK	OK
Diferenca	-	-

PER SH.A.ALBKROM NE LIKUIDIM E SIPER TIRANE

L I K U I D A T O R I

Fejzi LILA

Fejzi Lila

REPUBLIKA E SHQIPERISE
QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT
SH.A. ALBKROM

Spjegime dhe komente per zera te ndryshem te bilanci

Gjendja dhe ndryshimet e AAM-ve, amortizimet dhe zhvleresimet

	Gjendjet dhe levizjet	Toka troje	Ndertesa	Galerite	Aktivet te tjera afatgjata materiale	Totali
A	Kosto e AAM-ve me 01.01.2012	68,335,634	215,647,653	1,311,659,740	405,252,950	2,000,895,977
	Shtesat	-	-			-
	Pakesimet (Shitjet)	-	-	-	2,206,025	2,206,025
	Nxierrje jashteperdorimit etje	-	-	-	129,584,621	129,584,621
	Kosto e AAM-ve 31.12.2012	68,335,634	215,647,653	1,311,659,740	273,462,304	1,869,105,331
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2012	-	172,614,067	1,192,353,356	347,715,940	1,712,683,363
	Amortizimi ushtrimit	-	10,735,418	65,582,986	14,815,977	91,134,381
	Amortizimi per shitjet e AAM-ve	-	-	-	-	-
	Amortizimi per daljet e tjera	-		-		-

	Amortizimi i AAM-ve 31.12.2012	-	183,349,485	1,257,936,342	362,531,917	1,803,817,744
C	Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2012	-	-	0		-
	Shtesat	-	-	0	-	-
	Pakesimet	-	45,944	0	121,661,485	121,707,429
	Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2012	-	(45,944)	-	(121,661,485)	(121,707,429)
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2012	68,335,634	32,252,224	53,723,398	(210,731,098)	(56,419,842)
						-
	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2012	68,335,634	32,344,112	53,723,398	32,591,872	186,995,016

-

0

Percaktimi i rezultatit tatimor-Shpenzime per tatim fitimin

					Kontrolli
I	FITIMI NETO PARA TATIMIT				
II	SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)				
1	Amortizime tej normave fiskale				
2	Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor				
3	Gjoba,penalitete,demshperblime				
4	Provizione qe nuk njihen				
5	Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta				
6	Te tjera-materiale jashte perdorimit(pa miratim)				
III	PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)				
IV	FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)				
V	Shpenzimi i tatim fitimit-10%				
VI	FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)				

Diferenca

Emertimi	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011	Ushtrimi paraardhes 31 Dhjetor 2011
Shpenzime te tjera		
Komisione shitje nga te trete		0
Qera zyrash+autojmetesh		
Blerje karburant		
Kancelari +shtypshkrime		
Shpenzime postare dhe transporti		

Shpenzime telekomunikacioni		
Pagea te ndermjetsave dhe honorare		
Shpenzime sherbimi bankar		
Mirmbajtje she riparime		
Te tjera te ndryshme		
Abonime te ndryshme		
Reklam publicitet		
Shpenzime pritje		
Pagese rojesh		
Taksa lokale te paguara		
Mbyllje e rivleresim e pa njoh		
Shuma	-	-

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SH.A. "ALBKROM" (Në Likuidim e Sipër)

T I R A N Ë

KËSHILLI MBIKQYRËS

V E N D I M

Nr. 3 datë 19.08. 2013

Për
Miratimin e llogarive të vitit 2012.

Këshilli Mbikqyrës i Sh.A. Albkrom (Në Likuidim e Sipër) Tiranë, i mbledhur sot me datë 19.08. 2013, pasi shqyrtoj relacionin e paraqitur nga shoqëria "Mbi miratimin e llogarive vjetore 2012 " sipas bilancit të hartuar nga shoqëria dhe të miratuar nga ekspertët kontabël të caktuar nga METE, mbështetur në nenin 130 të ligjit " Për Shoqëritë Tregtare me Nr. 7638 date 19.11.1992 " si dhe nenit 9, të Statutit të Shoqërisë,

V E N D O S I:

1.Miratimin e raportit të paraqitur nga ekspertët kontabël, dhe relacionin e Shoqerisë lidhur me rezultatet e vitit ushtrimor 2012 si me poshtë:

-Te ardhura	143.672.406 lekë
-Shpenzime	147.279.912 lekë
-Humbja e vitit	3.607.506 lekë

Për Këshillin Mbikqyrës
K R Y E T A R I
Stavri DHIMA

Adresa: Blloku: "Vasil Shanto"Mbrapa ish godines KESH-it Tiranë,Tël & fax : 00 355 4 2255459
E -mail: albkromsha@yahoo.com

RAPORTI
I AUDITIMIT të PASQYRAVE FINANCIARE

TE

"ALBKROM" SH.A, SHOQËRI NË LIKUJDIM E SIPËR

PËR VITIN 2012

EKSPERT KONTABEL të REGJISTRUAR, të PAVARUR
Mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare të Entitetit,
Prill-Maj 2013

© Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, Tiranë, maj 2013
Standarti Ndërkombëtar i Auditimit :(SNA) 210.

Ky raport është i mbrojtur me ligj. Përveç përdorimit nga persona të autorizuar nga aksioneri në mbështetje të ligjit 9901 dt. 14.04.2008"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", as i gjithë dhe asnjë pjesë e këtij raporti ose reference ndaj tij nuk mund të përfshihet në ndonjë dokument të botuar, qarkore ose deklarat, dhe as nuk mund të botohet pa miratimin tonë me shkrim për formën dhe kontekstin ku do të përdoret.

Për të marrë informacione rreth përmbajtjesë të këtij raporti ju lutem kontaktoni:

Znj. Arjeta Çumani,
Ekspertet Kontabël iRregjistruar, Liçenca EKR Nr.82
Antare e Insitutit të Ekspertëvë Kontabël të Autorizuar,(IEKA)
Selia e shoqërisë "A & B Auditing" Shpk, Lagja: Pavarsia,Vlorë
Filiali Tiranë, i shoqërisë "A & B Auditing" Shpk
Filiali Fier, i shoqërisë "A & B Auditing" Shpk
Telefon: (034) 262 97, cel 069 20 92 483
Faks: (034) 262 97
Email: lela_cu@yahoo.it

Znj.Fatime Alliu
Ekspert Kontabël e Rregjistruar;
Antare e Insitutit të Ekspertëvë Kontabal të Audititmit,(IEKA)
Mobil Phone 069 20 86 479;
Email: alliufato@yahoo.com

Qëllimi i këtij raporti është dhënia e sigurisë mbi Pasqyrat Fianaciare të shoqërisë "ALBKROM" Sh.A, Shoqëri në Likujdim e Sipër të mbyllura deri më 31 dhjetor 2012, si detyrim ligjor e statutor.

Për aksionerin ky raport do të paraqitet me shkrim;
Pregatitur nga Znj.Arjeta Çumani, Znj.Fatime Alliu

Tiranë, prill-maj 2013

30 maj 2013

Në respekt të Zotit ***Florion Mima***

Ministër

Ministria e Ekonomisë dhe e Energjitikës, Tiranë

I nderuar Ministër!

Kemi nderin t'ju paraqesim ***Ju,*** raportin e auditimit për vitin financiar të mbyllur më 31.12.2012, të Shoqërisë "ALBKROM" Sh.A. Shoqëri në Likujdim e Sipër, konform të gjitha ligjeve në fuqi.

Ky raport përmban një përmbledhje të raportit të auditimit të ekspertëve të pavarur dhe pasqyrat financiare të audituara, diskutime dhe analiza të raportit të drejtimit të shoqërisë, dhe pasqyrat financiare përkatëse.

Sinqerisht!

SHOQËRIME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Ekr.Arjeta Çumani

Ekr.Fatime Alliu

Ekspert Kontabël e Autorizuar FATIME ALLIU NIPT: K 72215028 T

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtimeve 1

I. PERMBLEDHJE E PËRGJITHSHME 2

II. HYRJA 5

III. OPINIONI I AUDITIMIT 6

IV. GJENDJA E REKOMANDIMEVE TE VITEVE TE KALUARA 9

V. REZULTATI FINANCIAR NE KRAHASIM ME BUXHETIN E APROVUAR 10

VI. PASQYRAT FINANCIARE 11

VI. 1 PAJTUESHMERI ME FORMEN RAPORTUESE DHE CILESINE E INFORMACIONIT 11

VII. REALIZIMI I BUXHETIT 12

VII. ..... 1 Të ardhurat (DUKE PERFSHIRE ATO AKTIVITETIT) 12

VII 2 SHPENZIMET 13

VII 3 SUBVENCIONET DHE TRANSFERET 14

VII 4 BILANCI 15

VII. KONTROLLI MBI MENAXHIMIN 18

VIII. 1 SISTEMET E KONTROLLIT TE BRENDSHEM 18

VIII. 2. AUDITIMI I BRENDSHEM DHE EKSPERTI KONTABËL I RREGJISTRUAR 19

IX. KONKLUZIONI I PERGJITHSHEM MBI MENAXHMIN E ALBKROM 20

SHTOJCA :

1. LLOJET E NDRYSHME TE OPINIONEVE TE AUDITIMIT BAZUAR NE ISSAI 4000 21

2: REKOMANDIMET E VITEVE TE ME PARSHEME 22

3. KOMENTET E "ALBKROM DHE PERGJIGJJA E EKR-VE 23

Lista e shkurtimeve

AB	Auditimi i Brendshëm
EKR	Auditori i Jashtëm
IKM	Inistituti i Kontabilistëve të Miratuar
IEKA	Instituti i Eksperteve Kontabël të Autorizuar
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
LKPF	Ligji nr.9228, datë 29.4.2004", Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"
LAKM	Ligji *nr.10 091, datë 5.3.2009*" Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Rregjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar"
K.C	Kodi Civil, në Republikën e Shqipërisë
KPA	Kodi i Procedurës Administrative
LPP	Ligji nr.9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me ligjin nr.9800 datë 10.09.2007, ligjin nr. 9855 datë 26.12.2007, ligjin ,nr. 10170, datë 22.10.2009, ligjin nr.10 309, datë 22.07.2010 dhe ligjin nr. 131/2012 "Për Prokurimin Publik"
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
IAASB	Bordi Ndërkombëtar i Standarteve të Auditimit
PF	Pasqyrat Financiare
Rr F	Rregullat financiare të nxjerra nga Ministria e Financave
SIMF	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave
SMZHB	Sistemi për Menaxhimin dhe Zhvillimin e Buxhetit (BDMS)
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI)
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SKK	Standartet Kombëtare të Kontabilitetit
DPNA	Direktiva e Praktikës Ndërkombëtare të Auditimit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
ALBKROM	"ALBKROM" Sh.A. Shoqëri në Likujdim e Sipër, Tiranë

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Eksperte Kontabel e Autorizuar
FATIME ALLIU
NIPT: K 72213028 T

I Përmbledhje e përgjithshme

Grupi i EKR ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare (PF) të "A L B K R O M" Sh.A, Shoqëri në Likujdim e Sipër, Tiranë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012, bazuar Urdhërin e Ministrit të METE, Nr.777 Prot. dt.23.01.2013.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit,(SNA, DPNA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat, që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare të deklaruara nga ALBKROM, i cili vjen si një suplement i kërkuar SNA 700.

Ne nuk kemi vëzhguar procesin e inventarizimin fizik të datës 31 dhjetor 2013, pasi ky proces u kryer nga entiteti para datës që ne u angazhuam me misonin e auditimit të shoqërisë. Për shkak të natyrës së gjëndjës së stokut në galeri e miniera dhe natyrës të regjistrave të shoqërisë ne nuk ishim në gjendje që, duke u nisur nga procedurat e auditimit, të bindeshim në lidhje me sasinë e stokut.

Sipas opinionit tonë, përveç disa problematikave të gjetura e përshkruara në paragrafin për bazat për kualifikim të opinionit me rezervë, pasqyrat financiare japin nje pamje te vertete dhe te sinqertë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Shoqëritë në Likujdim.

Raportimi Financiar është ndërtuar sipas SKK, bazuar në Parimet Kontabël,i mbajtur sipas të Drejtave të Konstatuara.

Ju lutemi, më poshtë ju do të gjeni një ekstrakt të marrë nga opinioni i auditimit në faqën 5 dhe 6 të këtij raporti:

Opinioni i rrjedhur prej Auditimit

Opinioni ynë,
Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të rregullimeve, në qoftë se do të kishte ndonjë të tillë, që mund të ishin përcaktuar të nevojshme për tu bindur përsa i përketë sasive të stokut dhe gjendjes së kreditorve e debitorve, ***pasqyrat finaciare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë në të gjitha aspektet materiale, të gjëndjeve financiare të shoqërisë më datën 31 dhjetor 2012,*** rezultati i veprimtarisë të saj dhe flukset e parasë për ushtrimin e mbyllur, në pajtim me SKK dhe SNRF dhe në respekt të Ligjit Nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare(ndryshuar me Ligjin Nr. 9477, date 09.02.2006)., Ligjit Nr. 9901 dt. 14. 04 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", statutin e Entitetit etj.

Mesazhi ynë kryesor në Vëmendjen tuaj, si Aksioner dhe Këshillin Mbikqyrës, i cili rezultoi në kualifikim të opinionit, është:

- ✓ Rekomandimet e AB të METE dhe EKR, të lëna nga viti i kaluar dhe rekomandimet e këtij viti, janë marrë në konsiderat nga drejtimi;
- ✓ Programi ekonomik i vitit 2013 (Projekt Buxheti), në përgjithësi është hartuar në përputhje me të gjithë elementet e kostos, e krahasuar me buxhetet e realizuara 1-2 vite më parë;
- ✓ Megjithëse, statusi i shoqërisë është "Shoqëri në Likujdim e Sipër", ne e konsiderojmë të rëndësishëm blerjen e një Software Kontabiliteti për administrimin dhe mbajtien e rregjistrimeve kontabël. Kjo

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Eksperte Kontabel e Autorizuar FATIME ALLIU NIPT: K 72215028 T

konsideratë vjenë duke pasur parasysh kohën e gjatë të likujdimit për të çuar drejtë zeros vlerën pasurore të këtij entitetit, me histori ekonomike, strategjike për vendin tonë, përgjegjësitë dhe rëndësinë e menaxhimit dhe administrimin e gjendjeve të Debitorëve dhe Kreditorëve, gjendjeve fiziket të inventarëve të përputhur me vlerat e inventarit kontabël deri në shitje të tyre, të cilat gjenden në disa ndërmarje me shtrirje të largët gjeografike nga qendra dhe nga njera-tjetra.

- ✓ Në koordinim me METE dhe ZRPP janë marrë në konsideratë alternativat e duhura për të siguruar vlerësimin e pasurive, të cilat edhe më tutje janë në përdorim; por është e rëndësishme marrja e Çertifikatave të Pronësisë për çdo objekt në përdorim nga ALBKROM dhe kthimi i tyre në përshtatje me kushtet e tregut, për të realizuar shitjen e tyre në një kohë sa më të afërt të mundshme.

- ✓ Ndjekja e procedurave ligjore për të drejta të arkëtueshme nga të tretët,debitor dhe klientët e rinjë si dhe, prej analizës së tyre të përcaktohet qëndrimi me vendimin e drejtimit për debitorët e humbur, mbi 10 vjetë.

- ✓ Kryerja e një analize për të gjithë Furnitorët e trashëguar nga "ALBKROM" Sh.A, të larguar nga Evidenca Kontabël në kundërshtim me ligjin, duhet të futen në bilancin e shoqërisë dhe të ndiqen rregullisht konformë Kodit Civil për të drejtat dhe detyrimet e pa realizuara deri në likujdimin e plote te shoqërisë.

- ✓ Për të gjitha detyrimet, për të cilat ka humbur interesi e janë të pa kërkuara mbi 10 vjetë, të parashkruhen sipas procedurave të parashikuara në Kodin Civil.

- ✓ Publikimi i entitetit në QKR, si Shoqëri në Likujdim e Sipër, konformë ligjit, si dhe bilancit të parë të mbylljes së shoqërisë dhe vendimeve të të marra nga Aksioneri në lidhje me të.

- ✓ Ruajtja e inventarve kontabël, si Assete (Aktive Afatë Gjata Materiale) për rastet e dhënies së konçesioneve dhe heqja nga inventari i Aktive Afatë Shkurtra,(Materiale e të tjera ndihmëse) dhe te diskutuhet e përcaktohet qëndrimi me vendimin e drejtimit për inventarët e mininierave të mbyllura e të dala nga funksioni.

- ✓ Ndjekia e diferencave të invetarëve me përgjegjësi, është një pikë e rëndësishme për drejtimin, si për fushën e administrimit korekt të tyre ashtu dhe për fushën e menaxhimit të shitjeve tyre duke realizuar një vlerë sa më të lartë në treg.

Për sa më sipër, ne nuk do të shprehim ndonjë opinion apo ndonjë qëndrim tonin lidhur me këto probleme, por thjesht i përmendim si çështje të cilat mendojmë se duhet të jenë në vemendje të Drejtimit. Ky qëndrim i yni lidhet me *objektivitetin dhe parimet e përgjithshme që drejtojnë Aauditimin e Pasqyrave Financiare* dhe Standarti 250.

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K. ALBANIA

Eksperte Kontabel e Autorizuar FATIME ALLIU NIPT: K72215028T

Kontrolli i brendshëm

Auditimi ynë ka kushtuar vëmëndje në fushën e menaxhimit financiar. Transaksionet objekti auditimi, janë të përshkruar në më shumë detaje brenda këtij raporti.

Konkluzioni ynë është që sistemi i kontrollit të brendshëm i Entitetit ka nevojë për t'u strukturuar dhe përmirësuar në mënyrën e duhur, për implementimin e sistemit informatik të kontabilitetit dhe administrimi i tij. Këto duhet të mbahen në vëmëndje për të përmirësuar performancën e Entitetit, për objektin që ajo ka deri në likujdim.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, ne i rekomandojmë Entitetit që të sigurojë:

- Të mbahet një listë e plotë e pronave, me genplanet dhe planimtrite përkatese,
- Të mbajë një listë të plotë të impianteve dhe makinerive e pajisjeve të Entitetit; me dokumenta teknik përkatëse.
- Të mbajë një listë të plotë të inventarit të produktit të gatshëm të magazinuar në pista (mbi tokë) dhe gjendjes së inventarëve që gjenden brenda në galeri
- Të sistemohen në kontabilitet gjendjet e inventarit, që i përkasin galerive të mbyllura dhe inventarëve afatshukërtër që janë në përdorim të ndërmarrjeve të dhëna me konçesion.
- Të merren masa për të rritur nivelin e arkëtimeve të klientëve mbi një vit; dhe më shumë se një vit.
- Të sigurojë zbatimin në mënyrë të plotë të procedurave të shitjeve me ankand në përputhje me Ligjin nr.9874, datë 14.02.2008, "Për Ankadin Publik",VKM nr.48, datë 06.06.2010 "Rregullat për Anakndin Publik", VKM nr 1719, datë 17.08.2008, "Për Ankandin Publik"
- Rishikimi i sasive të stokut (produktit të mineralit) dhe axhustimi i çmimit të stokut, vlerësuar sipas vlerë së drejtë të tregut, refruar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe udhëzimit nr.30, datë 27.12.2012 të Ministrisë së Financave , nisur dhe nga inventaret fizike të kryera për vitin 2012.

Menaxhimit të Entitetit i është dhënë mundësia për të komentuar mbi problemet e prezantuara në këtë raport. Menaxhimi ka pranuar problemet e ngritura nga ne dhe konkluzionet e paraqitura në raportin e auditimit, të pasqyrave financiare që i përkasin vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2012 dhe kanë premtuar të bëjë të gjitha përpjekjet, për të zbatuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

(Refer. Shtojces 3 për përmbledhjen e rekomandimeve tona dhe përgjigjet tona ndaj tyre)

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K TIRANË

Eksperte Kontabel e Autorizuar FATIME ALLIU NIPT: K 72215028 T

II. Hyrja

Ky auditim ka te bëjë me Pasqyrat Financiare të shoqërisë ALBKROM për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012.

Eshtë përgjegjësia e drejtimit të Entitetit të përgatisë pasqyrat vjetore financiare sipas kërkesave të kërkuara nga ligj Nr.9228, date 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"dhe në përputhje me IFRS për "Raportimin financiar" bazuar në kontabilitetin e mbajtur sipas të drejtave të konstatuara.

Grupi EKR, është përgjegjës, pa pasoja ligjore, për kryerjen e auditimit vjetor, për pasqyrat financiare të Entitetit për vitin ushtrimor që përfundon më 31 dhjetor 2012.

Auditimi përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare si dhe jep siguri në:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërine e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Çështje të tjera me rëndësi të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Kemi kryer vlerësime paraprake të Entitetit. Gjatë këtij vlerësimi, i kemi kushtuar vëmëndje, si element shumë të rëndësishëm, realizimit të rekomandimeve të auditit të mëparshëm nga Entiteti si dhe cilësinë e menaxhimit financiar.

Sa më sipër ne kemi këshilluar menaxhimin, nëpërmjet rekomandimeve tona të cilat përfshijnë edhe këshilla në lidhje me përmirësimet e pasqyrave financiare, në mënyrë që ato të jenë në pajtim me ligjin për fuksionimin e Administratës Publike dhe Ligjin e kontabilitetit, për aplikimin e Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit, për "Raportimin Financiar" dhe në pajtim me parimit kontabël, në vijushmëri të politikave të ndjekura nga entiteti.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive tona për auditimin e Entitetit, ne kemi ndërmarrë një auditim si në vijim:

→ Kemi rishikuar pasqyrat vjetore financiare në raport me Planin Ekonomik (plan-buxhetin) e miratuar për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2012;

→ Kemi përcaktuar nëse pasqyrat vjetore financiare të Entitetit janë përgatitur në pajtim me SKK, "Raportimi Financiar" në bazë të Kontabilitetit të të drejtave të konstatuara, parimit të vijushmërisë, dhe Kodi i Procedurës Administrative në Shqipëri;

→ Kemi përcaktuar nivel të materialitetit, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;

→ Kemi zbatuar një kombinim të kampionit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;

→ Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare; dhe jemi mbeshtetur në një kombinim të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërine dhe rregullsinë e transaksioneve financiare.

Në këtë raport ne kemi përmbledhur auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal, pa pasoja ligjore mbi Pasqyrat Financiare që i përkasin vitit ushtrimor, që u mbyll më 31 dhjetor 2012.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Entietit, Standartet Ndërkombëtare të Auditimit, përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

(Shënime të cilat janë të përcaktuara me gjerësisht në Shtojcen 1 që përfshin një prej SNA)

SHOQËRIMI PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Ekspert Kontabel e Autorizuar FATIME ALLIU NIPT: K 72215028 T

III. Opinion i Auditimit

RAPORT AUDITIMI i EKSPERTIT të PAVARUR

Drejtuar:
KESHILLIT MBIKQYRES të SHOQERISE,
"ALBKROM" Sh.A, SHOQËRI NË LIKUJDIM E SIPËR, TIRANË
Lidhur me shqyrtimin e llogarive vjetore të periudhes Janar - Dhjetor 2012

Fusha e Auditimit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të ***"ALBKROM" Sh.A. Shoqëri në Likujdim e Sipër, Tiranë***, në lidhje me ushtrimin e mbyllur më dt.31 Dhjetor 2012. Pasqyrat Financiare përfshijnë:

- Rezultatin Fitim/humbje, gjëndjen e llogarive të bilancit të entitetit;
- Lëvizjet e Kapitalit;
- Performancën e gjëndjeve financiare, pozicionin financiar dhe rrjedhjen e parave (Cash flow);
- Ngjarjet e rastësishme dhe përfshirjen e tyre;
- Administrimin në kohë të të ardhurave dhe shpenzimeve, asseteve dhe detyrimeve, Cash flow, ngjarjeve të rastësishme dhe përfshirjen e tyre;
- Shënime në drejtim të krijimit të gjendjeve financiare.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

"ALBKROM" , është përgjegjese për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare dhe informacioneve që ato përmbajnë në përputhje me SKK dhe SNRF. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe ruajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi ose gabimi. Gjithashtu ato mbajnë përgjegjësi për zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve kontabël të përshtatshme dhe duke bërë vlerësime kontabël që janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Audituesve

Ne kemi drejtuar një auditim të pavarur të gjendjeve financiare me qëllim për të shprehur një opinion, bazuar në rishikimin tonë.

Kryerja e auditimit është bërë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike, si edhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përftojmë siguri të arsyeshme në se pasqyrat finaciare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e proçedurave për të përftuar të dhëna auditimi, për shumat dhe shënimet e pasqyrave financiare. Proçedurat e përzgjedhura janë të varura nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale tek pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit ose gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të pregatitura nga drejtimi, me qëllim hartimin e proçedurave të tilla auditimi që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllim shprehjen e një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë të parimeve kontabël të përdorura dhe të arsyetimit të vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne nuk vëzhguam inventarizimin fizik të dates 31 dhjetor 2012, pasi ajo datë ishte para dates që ne u angazhuam fillimisht si audites për entitetin. Për shkak të mënyrës së mbajtjes kontabilitetit dhe stokut ne e kishim të vështirë të bindeshim në lidhje me sasitë e stokut.

Ne vëzhguam grupin e detyrimeve dhe të drejtave që ***"ALBKROM"*** ka tek të tretët, si dhe realizimin e kostove të likujdimit, krahasuar me Programin Ekonomik të aprovuar në fillim të vitit ushtrimor nga drejtimi.

Në besojmë se evidenca që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë opinionin tonë.

Opinioni i ynë i shprehur në këtë raport është formuluar në bazë të deklarimeve të mësipërme

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Eksperte Kontabel e Autorizuar FATIME ALLIU NIPT: K 72215028 T

Opinioni i rrjedhur prej Auditimit

Opinioni ynë,
Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të rregullimeve, në qoftë se do të kishte ndonjë të tillë, që mund të ishin përcaktuar të nevojshme për tu bindur përsa i përket sasive të stokut dhe gjendjes së kreditorve dhe debitorve, ***pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë në të gjitha aspektet materiale,*** të gjëndjeve financiare të shoqërisë më datën 31 dhjetor 2012, rezultati i veprimtarisë të saj dhe flukset e parasë për ushtrimin e mbyllur, në pajtim me SKK dhe SNRF dhe në respekt të Ligjit Nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare (ndryshuar me Ligjin Nr. 9477, date 09.02.2006)., Ligjit Nr. 9901 dt. 14. 04 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", statutin e Entitetit etj.

Theksim i çështjeve

Pa modifikuar opinionin tonë, në tërheqim vëmendjen si në vijim:

- Edhe pse Entiteti ka përgatitur dhe publikuar një listë të plotë (inventari) të pasurive të Paluajtëshme, mund të ketë paqartësi lidhur me të drejtat e pronësisë mbi pronat të administruara nga Entitetit dhe te Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Pauajtëshme dhe mungesë të dokumentacionit të pronësisë.
- Për shkak të mungesës të dokumentacionit mbështetës për matjen e një pjese të rëndësishme të pronës, objekteve dhe pajisjeve, të deklaruara në Seksioni 16, Entiteti ka tentuar që të matë këta artikuj me vlerën e drejtë të tregut në bazë të një vlerësimi të kryer nga grup Ekpertesh të Vlerësimit të Pasurive të Paluajteshme të emëruar nga METE. Vlerat e raportuara në pasqyrat financiare janë të mbështetur nga raportet e vleresimit të viteve të mëparshëme.
- Mungesa e rivlerësimit dhe sisitemimit të diferencave të inventarit, stokut për mineralin e kromit në se ekziston nga periudhat e më parshme, rezervon cënimin e të ardhurave të prishtëshme, për pasojë dhe PF të mbyllura në vitin 31 dhjetor 2012.
- Dhe pse planifikimi dhe paraqitja e Buxhetit në PF deklarohet korrekt sipas evidencës kontabël të mbajtur sipas parimit të drejtave të konstatuara, gjatë periudhës së auditimi u konstaua se grupi i krediorëve është prekur duke cënuar plotësinë e tij, si pasojë ka sjellë ndryshime në PF të viteve të më parshme të cilat reflektojnë dhe në PF të mbyllura në vitin 31 dhjetor 2012.

Rishikimi i përputhshmërise

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një opinion me siguri të kufizuar nëse, në të gjithë aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me pjesën e plotësisë, ekzistencën fizike, dhe që administrohen realisht nga autoritetet e drejtimit (Entiteti). Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmerine ishin të kufizuara krahasuar me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion bazur në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 dhe SNA 120. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjithë aspektet materiale me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie.

Ne besojmë se evidenca, që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për konkluzionet

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Eksperte Kontabel e Autorizuar FATIME ALLIU NIPT: K 72215028 T

Konkluzione për Përputhshmërinë

Bazuar në punën tone, të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë rishikimit, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

Çështje të tjera

Ne tërheqim vëmendjen për sa më poshtë:

1 Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Balanci Vërtetues, Centralizatori. Meqënëse Bilanci Vërtetues është rezultat i Centralizatorit, i cili paraqet shumatoren e plotë të gjitha regjistrimeve kontabël të gjitha transaksioneve tregtare dhe financiare me palet e treta përdoret të prodhojë pasqyra të plota financiare.

2 Megjithëse Likujdatori dhe K/ Financiar kanë nënshkruar deklaratën për prezantimin e pasqyrave financiare në kohë, entiteti nuk ka dorëzuar akoma pasqyrat financiare të mbyllura deri me 31 janar 2012 në institucionet METE, QKR, por i ka dorzuar ato vetëm në Drejtorinë Rajonale e Tatimeve Tiranë.

3 Meqënëse ALBKROM nuk ka implementuar nje Sistem Kontabël Informatik, një sistem gjithëpërfshirës kontabël, ekziston një pasiguri lidhur me plotësinë e arkëtimeve dhe, aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë, për të deklaruar një raport të saktë të ardhurave, dhe për të monitoruar arkëtimet e kryera në kohë.

Tiranë 30 Maj 2013

EKSPERTET KONTABEL të REGJISTRUAR

Arjeta Çumani Arjeta Çumani

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A&B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Fatime Alliu Fatime Alliu

Eksperte Kontabel e Autorizuar
FATIME ALLIU
NIPT: K 72215028 T

IV. Gjendja e rekomandimeve te viteve të kaluara

Letra jonë e dërguar eksperti të mëparshëm, na konfirmon se për vitin që përfundoi me 31 Dhjetor 2012, nuk kishte rekomandime të veçanta për autoritetin e drejtimit.

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A&B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Eksperte Kontabel e Autorizuar
FATIME ALLIU
NIPT: K72215028T

V. Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar

Analiza e Rezultatit ne Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit te Aprovuar tregon,Tabela 1:

Përshkrimi i buxhetit dhe shpenzimeve

Nr	EMERTIMI	Njesia e matjes	Programi Ekonomik	Realizimi vitit ushtrimor 31.12.2012	Realizimi vitit ushtrimor 31.12.2013	Realizimi 2012 ndaj faktit 2011 ne %
VI	Treguesit financiare					
A	**Te ardhura(pa subvencion)**	mln/leke	15.20	124.95	35.61	3.51
	nga keto sipas burimeve:	mln/leke	-			
	Shitje mallrash	mln/leke	4.00	12.42	34.27	36%
	Shitje asetesh	mln/leke	8.00	0.00	0.00	
	te tjera, nga aktivitetti kryesor	mln/leke	3.20	112.53	1.34	83.72
B	**Subvensione**	mln/leke	3.00	5.00	3.70	1.35
C	**Totali te ardhura (A+B)**	mln/leke	18.20	129.95	39.31	3.31
D	**Shpenzime gjithesej(1+2+3+4)**	mln/leke	95.03	(133.56)	(256.10)	52%
	Nga keto	mln/leke				
1	***Paksimi i gjendjes prodhimit***	mln/leke	6.00	(9.31)	(27.00)	34%
2	***Shepnz.te shfryt.e rrjedhse***	mln/leke	81.83	(116.11)	(110.02)	1.06
	Materiale te para	mln/leke	-			
	Mallra	mln/leke	-			
	Furnitura	mln/leke	-	0.00	0.00	0.00
	(mbyllje -konservim-demolim)	mln/leke	4.00	0.00	0.00	0.00
	Telefon celular	mln/leke	0.12	0.00	0.00	0.00
	Paga personeli	mln/leke	14.43	(13.44)	(19.98)	67%
	Sigurime shoqerore	mln/leke	5.70	(1.88)	(2.22)	85%
	Tatime e taksa(taksa automjetesh)	mln/leke	0.40	0.00	0.00	0.00
	Shpenzime te tjera rrjedhese	mln/leke	1.70	0.00	0.00	0.00
	Amortizime	mln/leke	54.00	(100.79)	(87.82)	1.15
	Provizione	mln/leke	3.00	0.00	0.00	0.00
3	***Shpenzime financiare***	mln/leke	1.20	(8.14)	(120.08)	7%
	Diferenca kembimi	mln/leke	0.20	0.00	0.00	0.00
	Te tjera	mln/leke	0.60	(8.14)	(120.08)	7%
	Interesa	mln/leke	0.40	0.00	0.00	0.00
4	***Shepnzime jashtezakon***	mln/leke		0.00	1.00	0.00
	nga keto					
	Shlyerje kreditoresh	mln/leke		0.00	1.00	
E	**Fitimi para Tatimit**	mln/leke	(75.83)	(3.61)	(216.79)	2%

Shumat e buxhetuara jane marrë nga seksioni vijues i pasqyrave financiare të vitit që perfundoi më 31 Dhjetor 2012: (Ref.Seksioni 13 *Raporti i Ekzekutimit te Buxhetit)*

Konluzioni

Të ardhurat substanciale për entitetin pa subvencionet, për vitin 2012 janë realizuar 3.51 herë më shumë në krahasim me vitin 2011 ose janë realizuar 8.2 herë më shumë nga Buxheti i Planifikuar (Plani Ekonomik).

Në total të ardhurat aktuale nuk i mbulojnë shpenzimet, kjo diferencë është mbuluar pjesërisht nga transfertat e subvencioneve prej METE, të cilat janë të llogaritura për mbylljen shpenzimeve operative

Buxheti i vitit 2011 ishte me i ulët se ai i vitit 2012, Te gjitha planifikime të buxhetit dhe subvencioneve, si dhe ndryshimet e bëra në buxhetin fillestar janë miratuar nga drejtimi.

Buxheti i pa shpenzuar i ALBKROM në vitin 2012 përputhej me gjendjen e rrjedhur sipas Pasqyrës Cash Flow

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A&B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Eksperte Kontabel e Autorizuar FATIME ALLIU NIPT: K 72215028 T

VI. Pasqyrat financiare

VI. 1. Pajtueshmëri me formën raportuese dhe cilësinë e informacionit

Kërkesat nga LKPFdhe Rregulla Administrative sipas KPA.

- Entiteti ka përgatitur pasqyrat financiare sipas Rregullave financiare të kërkuara nga LKPF dhe SKK;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Likujdatori dhe K/ Degëssë Financës i entitetit të audituar;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar brënda kohës së kërkuar, në daten 31 mars 2013 dhe ende nuk janë dorëzuar në METE; dhe QKR. por janë deklaruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë
- Pasqyrat Financiare janë përgatitur vetëm në gjuhën Shqipe; dhe të gjitha vlerat janë deklaruar në monedhën vëndase LEKE.
- Entiteti ka përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta, çdo tre mujor tek METE gjate vitit 2012.

Rekomandimi 1

Ne i rekomandojme Likujdatorit të Entitetit, që të sigurojë, që Entiteti duhet të përgatisë pasqyrat financiare me një ambjent të informatizuar, program kontabiliteti shqiptar ose te huaj.

SHOQËRIMI PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Ekspert Kontabel e Autorizuar FANIME ALLIU NIPT: K 72215028 T

VII. Realizimi i Buxhetit

VII.1 Të ardhurat (duke përfshire ato aktivitetit)

Të Ardhurat:

- Paraqesin gjëndjen kontabël, sipas ndryshimeve në kohë bazuar në dokumentat ligjore si Mandat Arkëtimi, të rregjistruara dhe në librat e Arkës.
- Mardhëniet kontraktuale me Bankat, kanë prodhuar të ardhura nga interesat e cila është deklaruar drejtë në pasqyrën e të ardhurave, në rubrikën të ardhura të tjera.
- Të ardhurat kryesore janë realizuar nga shitjet të cilat janë pasqyruar drejtë në llogarinë e të ardhurave në momentin që ka ndodhur transaksioni.
- Mardhëniet kontraktuale me qiramarrësit janë pasqyruar korrekt në llogarinë e të ardhurave në momentin që ka ndodhur transaksioni
- Fitimi në këmbime valutore është një element tjetër në transaksionet operacionale të shoqërisë i cili është maturuar me kursin ditor të Bankës së Shqipërisë dhe është deklaruar drejtë në pasqyrën e të ardhurave, në rubriken të ardhura të tjera.
- Subvencione për konservim dhe mbyllje të dhëna nga buxheti janë pasqyruar drejtë në llogarinë e të ardhurave
- Të ardhura nga kalimet e kreditoreve në rezultat me vendim te keshillit mbikqyres,
- Të ardhurat nga rimarrje amortizimesh

Nga testet e kryera ne kemi vëne re:

- Të ardhurat regjistrohen në librin e arkës(për arkëtimet cash) dhe në mënyrë manuale mbahen në ditarin e arkës dhe atë të Bankës, duke azhornuar artikuj kontabël në centralizator të mbajtur manualisht në kompjuter (Excel)

Rekomandimi 2

Implementimin e një sistemi informatik kontabël që përfshin detaje të përditësuara për paguesit (klient dhe qiramarrës), adresat e tyre korrente, historikun e arkëtimeve dhe ndryshimet e nivelit të kuotave të arkëtuara prej klienteve dhe qiramarrësve. Informacione të tilla duhet të jenë të limituara vetëm për një numër të personash dhe që duhet të jenë të autorizuar nga menaxhimi

SHOQËRIME PËRGJIGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K "ALBANIA"

Eksperte Kontabel e Autorizuar
FATIME ALLIU
NIPT: K 72215028 T

2 Shpenzimet

2.1 Blerjet përmes prokurimit

Paraqesin gjëndjen kontabël, bazuar në dokumentat justifikuese si Fletë Hyrje, mandat pagesat e U.XH

Ne kemi venë re se është vepruar në përputhje me ligjin "Për prokurimet" nga Entiteti ne vitin 2012 në fushën e shpenzimeve. prokurimet realizohen kryesisht për blerje karburante, shpenzime kancelarie si dhe shërbimi i sigurisë ruajtje objektesh.

2.2 Blerjedhe shpenzime të tjera

Paraqesin gjëndjen kontabël, bazuar në dokumentat justifikuese si mandat pagesat e U.XH

Në zërin e shpenzimeve të tjera janë paraqitur shpenzimet e kryera për energji elektrike, naftë, komisione bankare, detyrime për tatime dhe taksa, të cilat janë totalish të identifikushme nga faturat tatimore e deklaratat fiskale. I gjithë grupi eshte rregjistrua korrekt në kontabilitet sipas parimit të drejtave të konstatuara duke i përgjigjur drejtë llogarive përkatëse të detyrimeve.

2.3 Mallra dhe Materiale të konsumuara.

Paraqesin gjëndjen kontabël, bazuar në dokumentat justifikuese si Fletë-Daljet.

Përfshin të gjitha shpenzimet që janë kryer për blerjen e mallrave si dhe materialeve e lëndëve të tjera ndihmëse, me vlerën reale të tregut në momentin kur ka ndodhur transaksioni dhe janë korigjuar korrekt me ndryshimin e gjëndjes së mallrave e materialeve në magazinë, duke dhënë në mënyrë korrekte gjendjen e evadimit të tyre nga magazina përkonsum të brendëshëm.

2.4 Shpenzime për personelin (pagat, shpërblime të personelit dhe sigurime shoqërore)

Në zërin paga, është deklaruar paga bruto për personelin, e cila është e kuadruar me ditarin e pagave dhe listëpagesat.

Në zërin sigurime shoqërore dhe shëndetësore paraqiten sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në total për punëdhënësin konform normave ligjore të ndryshuara në kohë.

Po në këtë rrubrikë janë deklaruar pagat vjetore për këshillin mbikqyrës të cilat janë aprovuara nga drejtimi dhe janë konformë ligjit.

<u>Rekomandimi 3</u>

Ne rekomandojmë që Likujdatori të sigurohet se Entiteti do të ndërmarrë hapa të mëtejshme për përmirësimin e kontrolleve të brendëshme dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve të miratuara nga Aksioneri përsa i përket personelit.

2.5 Shpenzimet e amortizimit

Shoqëria ka llogaritur shpenzime për amortizimin, për efekte fiskale dhe për efekte manaxheriale, duke ruajtur normat ligjore fiskale.

SHOQËRI PËRGJIGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Ekspert Kontabel e Autorizuar FATIME ALLIU NIPT: K 72215028 T

VII. 3 Subvencionet dhe Transfertat

	Viti 2012 000/lekë	Viti 2011 000/lekë
-Subvencione	5,000	3,700
-Rimarrje	638	997
- Gjithsej të Ardh. dhe transferim i Subvencioneve	**5,638**	**4,697**

Subvencione të përfituara nga Entiteti në vite, janë përdorur për demontim dhe konservim në vitin ushtrimor si dhe është rimarrë një shumë për të kaluar në mbyllje të vlerës së amortizimit vjetor të ndërtesave.

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Eksperte Kontabel e Autorizuar FATIME ALLIU NIPT: K 72215023 T

VII. 4 BILANCI

Bilanci Kontabël i datës 31 Dhjetor 2012

A	AKTIVI	Shënime	Viti raportues 31.12.2012	Viti paraardhës 31.12.2011
I	AKTIVET AFATSHKURTRA		185,132,740.00	216,742,020.00
1	**Aktive monetare**	1	13,704,626	25,328,558
	Totali 2		**0**	**0**
3	**Aktive të tjera financiare afatshkurtra**	2	155,096,219	166,528,609
	(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme		11,140,344	18,321,502
	(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme		137,555,875	137,099,805
	(iii) Instrumente të tjera borxhi		6,400,000	11,107,302
	Totali 3		**0**	**0**
4	**Inventari**	3	16,331,895	24,884,853
	(i) Lëndët e para		40,801,981	42,327,246
	(iii) Produkte të gatshme		55,067,714	71,401,420
	(iv) Mallra për rishitje		28,633,850	28,633,850
	(v) Parapagesat për furnizime		(108,171,650)	(117,477,663)
	Totali 4		**16,331,895**	**24,884,853**
7	**Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra**			0
	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA (I)		**16,331,895**	**24,884,853**
II	AKTIVET AFATGJATA	4	4,175,873,065	4,276,954,416
1	**Investimet financiare afatgjata**			
	(iv) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme afatgjata		4,819,585	4,910,329
	Totali 1.		**4,819,585**	**4,910,329**
2	**Aktive afatgjata materiale**		186,995,016	287,985,623
	(i) Toka		68,335,634	68,335,634
	(ii) Ndërtesa		32,344,112	43,033,586
	(iii) Makineri dhe pajisje		53,723,398	119,306,384
	(iv) Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)		32,591,872	57,310,019
	Totali 2		186,995,016	287,985,623
4	**Aktivet afatgjata jomateriale**			
	(iii) Aktive të tjera afatgjata jomateriale		3,984,058,464	3,984,058,464
	Totali 4		**3,984,058,464**	**3,984,058,464**
5	**Kapital aksionar i papaguar**			0
6	**Aktive të tjera afatgjata**			0
	TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA (II)		4,171,053,480	4,272,044,087
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		**4,361,005,805**	**4,493,696,436**
B	**PASIVI**	**Shënime**	**Viti raportues 31.12.2012**	**Viti paraardhës 31.12.2011**
	DETYRIMET DHE KAPITALI			
I	**DETYRIMET AFATSHKURTRA**	5	**722,973**	**1,172,156**
1	**Derivativët**			0
2	**Huamarrjet**			
	Totali 2		**0**	**0**
3	**Huatë dhe parapagimet**		**722,973**	**1,172,156**
	(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve		459,136	922,987
	(v) Parapagimet e arkëtuara		263,837	249,169
	Totali 3		**722,973**	**1,172,156**
4	**Grantet dhe të ardhurat e shtyra**			0
5	**Provizionet afatshkurtra**			0
	TOTALI I DETYR. AFATSHKURTRA (I)			
II	**DETYRIME AFATGJATA**	6	**2,681,601,652**	**2,810,235,594**
1	**Huatë afatgjata**			
	(i) Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare		63,144,352	63,144,352
	Totali 1		**63,144,352**	**63,144,352**
2	**Huamarrje të tjera afatgjata**		169,840,292	298,474,234
3	**Grantet dhe të ardhurat e shtyra**		106,201,290	106,201,290
4	Te drejta e detyrime te Koncensionarit		2,342,415,718	2,342,415,718
				0
	TOTALI I DETYR. AFATGJATA (II)		**2,618,457,300**	**2,747,091,242**
	TOTALI I DETYRIMEVE			
III	**KAPITALI**	7	**1,678,681,180**	**1,682,288,686**
1	Aksionet e pakicës (përdoret vetëm në pasqyrat financiare të konsoliduara)			0
2	Kapitali që i përket aksionarëve të shoqërisë mëmë (përdoret vetëm në PF të konsoliduara)			0
3	Kapitali i rregjistruar(aksionar)		3,405,413,240	3,405,413,240
4	Primi i aksionit			0
5	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)			0
6	Rezerva statutore		1,545,062,358	1,545,062,358
7	Rezerva ligjore		39,410,111	39,410,111
8	Rezerva të tjera		25,074,303	25,074,303
9	Fitimet(humbja) e pashpërndara		(3,332,671,326)	(3,332,671,326)
10	Fitimi (humbja) e vitit financiar		(3,607,506)	0
	TOTALI I KAPITALIT (III)		1,678,681,180	1,682,288,686
	Koncesioni		0	**0**
	TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT (I,II,III)		**4,361,005,805**	**4,493,696,436**

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Eksperte Kontabel e Autorizuar FATIME ALLIU NIPT: K 72215028 T

4.1 **Paraqitja kontabël e bilancit.**

Paraqitja e bilancit konsiston:

- Në paraqitjen e bilancit të entitetit sipas natyrës së aktivitetit dhe specifikave ekonomike të tij.
- Rakordon me të dhënat e kontabilitetit.
- Reflekton në mënyrë besnike gjëndjen e shoqërisë në datën 31.12.2012.
- Është paraqitur sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit.
- Paraqet të gjitha ngjarjet ekonomike që kanë ndodhur gjatë vitit dhe ato që vijojnë në vitin pasardhës.
- Në përgjithësi bilanci i shoqërisë karakterizohet nga një rregullsi e pozicioneve të llogarive.

Baza ligjore: Bilanci është përpiluar sipas dispozitave në fuqi, në zbatim të Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" neni 1, paragrafi 3 dhe ligji Nr. 9228, datë 29.04.2004, ndryshuar me ligjin Nr. 9477, datë 09.02.2006 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 16, si dhe është marrë në konsideratë i gjithë legjislacioni fiskal i azhornuar që aplikohet në Shqipëri

4.2 **Paraqitja e aktivit të bilancit** reflekton në mënyrë besnike:

- Aty aktivet janë paraqitur të gjitha sipas gjëndjes kontabël të konfrontuar me inventarin fizik të tyre, të gjitha egzistojnë si pronë e shoqërisë.
- Këto aktive paraqiten në bilanc për një vlerë të pranueshme duke marrë parasysh pozicionet korigjuese koresponduese(amortizimet).
- Vlerat që u atribuohen aktiveve janë përcaktuar në mënyrë të tillë që mund tu referohen direkt atyre: në rast dyshimi, duke zgjedhur sistematikisht për vlerësimin me të kujdesshëm.

4.3 **Paraqitja e pasivit të bilancit** reflekton në mënyrë besnike:

- pasivet nuk përmbajnë asnjë mangësi.
- janë paraqitur të gjitha detyrimet dhe pasuria e vet shoqërisë (kapitali dhe rezervat) figuron atje në mënyrë korrekte.
- rezervat e nevojshme janë mbajtur në nivelin e duhur në krahasim me pozicionet e aktivit të cilave i përkasin.

4.4 **Vleresimit të likujditeteve**

Gjendjet e likujditeteve përfshijnë gjendjen e parave në arkë dhe në llogarite rrjedhëse në bankë në leke dhe në monedha të huaja.

4.5 **Vlerësimin e kërkesave për arketim**

Kërkesat për arkëtim vlerësohen me vlerën nominale (të skontuara nëse është materiale) minus humbjen nga zhvlerësimi.

4.6 **Vlerësimin e detyrimeve të pagueshme ndaj furnitorëve**

Detyrimet ndaj furnitorëve janë të vlerësuara mbi bazën e vlerës së tyre nominale.

4.7 **Huatë**

Huatë e marra me interes regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë. Pas njohjes fillestare janë të vleresuara me koston e amortizuar.Interesat e përllogaritura janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe detyrim në llogarinë e interesave të përllogaritura.

4.8 **Veprimet në monedha të huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj janë regjistruar në kontabilitet me kursin e Bankës së Shqipërisë në date ne kryerjes së transaksionit.

Asetet dhe detyrimet monetare në monedhe të huaj janë konvertuar në pasqyrën e bilancit me kursin e këmbimit të Bankes së Shqipërisë me 31.12.2012.Diferencat nga kursi i këmbimit të linduara nga konvertimi janë pasqyruar drejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Asetet dhe detyrimet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj janë konvertuar duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.
Asetet dhe detyrimet jo monetare në monedhe të huaj që paraqiten me vlerën e drejtë të konvertuara me kursin e këmbimit në daten kur vlera e drejtë është përcaktuar.

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI E KUFIZUAR "A & B AUDITING" SH.P.K *ALBANIA*

Eksperte Kontabel e Autorizuar
FATIME ALLIU
NIPT: K 72215028 T

4.9 **Vlerësimin e Gjendjeve të Inventarit.**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto e marrjes.

Gjendjet e Inventarit janë të vleresuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme:

4.10 Vleresimi Aktiveve Afatgjata Materiale

Aktivet Afatgjata Materiale (AAM) paraqiten në bilanc me vlerën e tyre bruto minus amortizimin e akumuluar. Shtesat e Aktiveve Afatgjta regjistrohen në kontabilitet me koston e marrjes.

Kosto e marrjes perfshin të gjitha shpenzimet e kryera per ta sjelle ate aktiv në vendin dhe kushtet ekzistuese.

Normat e amortizimit të aplikuara janë llogaritur në përputhje me normat e kërkuara nga ligji 8438, dt.28.12.1998 *"Për Tatimin Mbi Të Ardhurat"i ndryshuar* dhe marrin në konsiderate vleresimin e amortizimit sipas jetes se dobishme të aktivit.

Për llogaritjen e amortizimit janë aplikuar keto norma amortizimi:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortizimit në % 2012	2011	Metoda e llogaritjes
Toka	0	0	
Ndertime e instalime	5	5	
Galeri	5	5	
Makineri e Paisje	20	20	Mbi vleren e mbetur te AAGjata Materiale
Mjete transporti	20	20	
Paisje zyre	20	20	
Paisje kompiuterike	25	25	
Instrumenta dhe vegla pune	20	20	

Rekomandimi 4

Ne rekomandojmë që Likujdatori të sigurohet se Entiteti do të ndërmarrë hapa të metejshëme për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A&B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Eksperte Kontabel e Autorizuar FATIME ALLIU NIPT K 22215028 T

VIII. Kontrolli mbi menaxhimin

VIII. 1 Sistemet e Kontrollit te Brendshem

Të përgjithshme

Struktura e kapitalit dhe Organet e drejtimit

"ALBKROM" Sh.A me status, Shoqëri në Likujdim e Sipër, krijuar si shoqëri aksionere me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, nr 14014 datë 18/01/1996, e rregjistruar në Rregjistrin Tregtar dhe me Urdhërin nr 38,datë 01.03.2004, të aksionerit të vetëm shtetë, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës-shkurt METE, sipas vendimit nr 14014/5,datë 01.03.2004, është vendosur prishja e shoqërisë dhe kalimi i saj në likujdim. i gjithë procesi i likujdimit është në përputhje me ligjin 9901, dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregetare".

Selia e shoqërisë: është në adresën "Blloku Vasil Shanto"Tiranë.
Adresë tjetër e shoqërisë është në qytetin e Durrësit, lagja „Skëndërbej"

Objekti i veprimtarisë të entitetit : është Likujdimi i Shoqërisë ***"ALBKROM"*** Sh.A.

ALBKROM, Tiranë është shoqëri me një aksioner shqiptarë, Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës (Shteti) e cila zotëron 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i shoqërise është 3.405.413.240,00lekë, i përbërë nga ***3.405.413*** aksione, me vlerë nominale 1000lekë/aksioni

Në drejtimin e entitetit organi drejtues i shoqërisë në përputhje në statusin e saj është:

Këshilli Mbikqyrës, i përbërë si më poshtë:

Emri		*Funksioni*	*Vendodhja*
Stavri	Dhima	Kryetar i Këshillit Mbikqyrës	Tiranë
Sonila	Malko	Anetar i Këshillit Mbikqyrës	Tiranë
Flir	Mosho	Anetar i Këshillit Mbikqyrës	Tiranë

Dhe

Organi Ekzekutiv, i Administrimit, i cili paraqitet si më poshtë:

Emri		*Funksioni*	*Vendodhja*
Kujtim	Mezini	Likujdator	: Tiranë
Qazim	Murja	K/Deges se Finances	Tiranë

Si person juridik, Shoqëria është e regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Taranë, me:**NIPT J61827513H.**

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Eksperte Kontabel e Autorizuar
FATIME ALLIU
NIPT: K 72215028 T

Mbi kontrollin të brendshem.

Shoqëria nuk ka njësi të veçantë të kontrollit të brendshëm. Kontrolli i brenshëm që lidhet me funksionet e sistemit kontabël dhe me pohimet e pasqyrave financiare, është realizuar nëpërmjet mbikqyrjes së punëve nga punonjësit e ngarkuar me administrimin dhe nga likujdatori i shoqërisë..

Sistemi i autorizimeve për kryerjen e transaksioneve, blerjet, shitjet, pagat, hyrjet dhe daljet janë kryer sipas përcaktimeve të vendosura në rregullat statutore dhe ligjore. Ne nuk konstatuam raste të shkeljes së tyre

Ne e konsiderojmë të rëndësishëm procesin e kontrollit të brenshëm për inventarizimin e realizuar nga entiteti në periudhën 05.09.2012 deri më 15.10.2012, për Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatshkurtra Materiale në lidhje me gjendjet e stokut të mineraleve dhe magazinave duke pasqyruar lëvizjet e tyre gjatë vitit ushtrimor 2012.

Gjithashtu konsiderojmë të rëndësishëm momentin në zhvillimin aktual, të bisnesit, e inkurajojmë dhe rekomandojmë dretjtimin, të kryej dokumetimin e çdo transaksioni me përgjegjësi.

Besueshmëria e informacionit financiar, transaksionet ekonomike, që kontrolluam, janë të shoqëruara me dokumentacion justifikues, veprimet janë hedhur me shumat e sakta dhe në llogaritë e duhura, i përkasin shoqërisë dhe periudhës ushtrimore. Kuadrimet e llogarive janë kryer periodikisht dhe janë mbikqyrur nga K/Financës. Janë hartuar pasqyra financiare të ndërmjetme dhe i janë raportuar drejtimit në kohë në përputhje kërkesat statutore dhe ligjore.

VIII. 2 Auditimi i Brendshem dhe EKR

Konstatime:

Gjatë ndjekjes së procedurave tona rezultoi se Auditimi i Brendëshëm, i cili qëndron si strukturë,në rangë Drejtorie brenda strukturave të METE, kishte ushtruar konrtoll dhe kishte lënë rekomandime të cilat ne i morëm në konsideratë duke vlerësuar qëndrimin dhe vendimarjet e drejtimit në lidhje me to. Në përfundim të çdo viti ushtrimor METE, emëron nje grup pre dy Ekr, për të kryer auditimin të jashtëm dhe të pavarur.

Ekr-të dhe të gjithë kontrollet e realizuar raportojnë tek Këshilli Mbikqyrës, pasi në këtë menyrë, sigurohen përgjegjësit e këtyre dy organeve që janë kryer, me një nivel profesional, korrektësë duke ruajtur pavarësinë.

.

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Eksperte Kontabel e Autorizuar FATIME ALLIU NIPT: K 72210028 T

IX. Konkluzioni i Përgjithshëm mbi Menaxhmin e ALBKROM

Konkluzionet e përgjithshme dhe rekomandime

Sa më sipër, si u diskutua në këtë raport, për të pasur përmirësime në drejtim të rritjes të administrimit të evidencës kontabël dhe kontrollit të brendshëm financiar, në lidhje me menaxhimin duhet tu bëhet kujdes pikave të më poshtëme:

- ✓ Rregjistrimi dhe marrja e dokumentave të pronësisë prane ZRPP, Tiranë
- ✓ Krijimi i sistemit të IT, për Informatizimin e Kontabilitetit
- ✓ Saktësimi i stokut dhe rishikimi i raportit të pronësisë për AAGJM.
- ✓ Ulja e numrit të Debitorve, si rrjedhojë e rritjes së arkëtimeve prej tyre.
- ✓ Rishikimi dhe trajtimi i Kreditorve sipas rangut konformë K.C

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "A & B" AUDITING SH.P.K *ALBANIA*

Eksperte Kontabel e Autorizuar
FATIME ALLIU
NIPT: K72215028T